

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Prioritetet programore të Shtyllës së Tretë (OSBE-së) për vitin 2004

8 janar 2004

OSBE-ja - Misioni në Kosovë - do të vazhdojë të kryejë në mënyrë të plotë funksionin e saj si shtyllë për ndërtimin e institucioneve pranë administratës së unifikuar të UNMIK-ut në Kosovë. Një Kosovë e qëndrueshme duhet të ketë institucionet që janë të afta të përmbushin detyrimet e tyre vendëse dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe kërkesat e parapara me Planin për implementimin e standardeve për Kosovën dhe me Mekanizmin Stabilizues dhe Përcjellës të Bashkimit Evropian. Për të plotësuar këto kërkesa të parashikuara me procesin për zbatimin e standardeve – shtylla e tretë (OSBE-ja) në kuadër të mandatit të saj duhet t’iu mundësojë institucioneve qeverisëse dhe të shoqërisë civile që të funksionojnë duke respektuar vlerat dhe standardet demokratike, përfshirë këtu edhe interesat, të drejtat dhe përfaqësimin e të gjitha bashkësive etnike në Kosovë.

Në vitin 2004, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK)¹ – shtylla e tretë e UNMIK-ut (OSBE) – do të përqëndrohet në: (1) qëndrueshmërinë e institucioneve të formuara; (2) ndërtimin e kuadrove në mesin e kosovarëve që do të përcjellnin institucionet e tyre se a janë duke iu përmbajtur standardeve demokratike. Sundimi i ligjit dhe barazia para ligjit paraqesin një parakusht themelor për qëndrueshmërinë. Shtylla e tretë (OSBE) do të mbështesë respektimin e sundimit të ligjit në praktikën e qeverisjes në nivel qendror dhe lokal, avansimin e standardeve profesionale për ushtrimin e funksioneve publike dhe do të inkurajojë mediat e lira dhe të përgjegjshme. Shtylla e tretë (OSBE) do të ndihmojë në themelimin e policisë, drejtësisë dhe sistemit penal funksional, të bazuar në paanshmëri dhe respekt për të drejtat e njeriut. OSBE-ja do të punojë me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-të) për t’iu mundësuar popullit të Kosovës të marrin sa më shumë përgjegjësi në institucionet e jetës publike, nën udhëzimin politik të PSSP-së. OSBE-ja do të sigurojë që një përgjegjësi e tillë do të ushtrohet duke marrë parasysh në mënyrë të plotë të drejtat e njeriut dhe që të gjitha komunitetet të jenë në gjendje të marrin pjesë në kuadër të të gjitha institucioneve, deri në atë masë sa është garantuar me dispozitat për secilin institucion. OSBE-ja do të vazhdojë të ngrisë aftësitë dhe zotësitë e zyrtarëve të zgjedhur dhe publik, të cilët ushtrojnë funksione publike. Shtylla e tretë (OSBE) do të vazhdojë të mbështesë përfshirjen e qytetarëve dhe figurave me ndikim në jetën publike. Në të gjitha programet e saj, OSBE-ja do të mbështesë parimin e së drejtës së qytetarit për të jetuar i sigurtë, si pjesëtar i integruar i shoqërisë.

Tri strategjitë e departamenteve të OSBE-së, të cilat përshkojnë të gjitha aktivitetet e kësaj shtylle do të vazhdojnë të jenë prioritet edhe për vitin 2004. Ato janë: (1) Sigurimi i kushteve adekuate për pakicat, në mënyrë që të mbesin në Kosovë dhe për kthim të qëndrueshëm të tyre. (2) Nxitja e pajtimit dhe tolerancës. (3) Përkrahja e së drejtës për kthim. Shtylla e tretë (OSBE-ja) si pjesë e UNMIK-ut, vendos bazat për kthim duke themeluar një kornizë ligjore dhe institucionale e cila mundëson kthimin e qëndrueshëm; duke nxitur dialogun ndëretnik; duke korrigjuar mungesën e sigurimit të përgjegjësisë nga ana e institucioneve të përkohshme dhe, pasi të jetë realizuar kthimi, shtylla e tretë (OSBE-ja) do të ndihmojë që të drejtat e pakicave të jenë të respektuara.

Monitoruesi i Kuvendit i Shtyllës së Tretë (OSBE-së) do të vazhdojë të ushtrojë funksionin e tij/saj në baza të mandatit të dhënë nga ana e PSSP-së, për të monitoruar Kuvendin e Kosovës, në bazë të dispozitave të Kornizës Kushtetuese dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Monitoruesi i Kuvendit – fillimisht i futur si masë për ndërtimin e mirëbesimit i miratuar në dhjetor 2002 – është pranuar nga të gjitha grupet politike në kuvend si një vëzhgues i pavarur, objektiv dhe i paanshëm i punimeve të kuvendit.

¹ Më shumë informata për programet e shtyllës së tretë (OSBE-së) mund t’i gjeni në OPA@omik.org dhe <http://www.osce.org/kosovo/>

Departamenti për Demokratizim (DD) i Misionit të OSBE-së do të punojë në përmirësimin e kapacitetit dhe efikasitetit të punës së Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) nëpërmjet programeve praktike për ndërtimin e kuadrove që kanë të bëjnë me qeverisjen në nivel lokal dhe qëndror, të shtimit të pjesëmarrjes së qytetarëve për të rritur përgjegjësinë nga ana e institucioneve në fjalë, shtimit të pjesëmarrjes së komunitetit dhe transparencës në nivel komunal dhe qëndror dhe së fundi edhe nëpërmjet mbështetjes së mediave të lira dhe të përgjegjshme në Kosovë. DD-ja është duke punuar mjaft drejt krijimit të institucioneve të fuqishme të pavarura dhe shoqërisë civile e cila do të mbikëqyrë punën e strukturave qeveritare të cilat janë fleksibile për t'i rezistuar presionit politik.

- *Programi për qeverisje lokale* funksionon në nivel të kuvendeve dhe komisioneve komunale për të përmirësuar funksionalitetin dhe respektimin e legjislacionit përkatës. Ky program përcjell dhe jep këshilla mbi ushtrimin e përgjegjësisë të bartura në nivel lokal për të siguruar ofrim të drejtë dhe të barabartë të shërbimeve dhe për të rritur bashkëveprimin dhe përgjegjësinë e strukturave komunale ndaj zgjedhësve të tyre. Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) do të jetë një partner kyç në përpjekjet e shtyllës së tretë (OSBE-së) për ngritjen e kuadrit.
- Sa i përket qeverisjes në nivel qëndror, DD-ja koordinon ofrimin e ndihmës për kuvendin dhe punon në përmirësimin e punës së anëtarëve të kuvendit dhe komisioneve parlamentare. Nëpërmjet të themelimit të pikave fokale parlamentare nëpër ministritë përkatëse, në kryeministri, DD-ja punon së bashku me IPVQ-të në rritjen e mbikëqyrjes së punës së ekzekutivit. Bashkëpunimi parlamentar në EJK mëtohet të rritet edhe nëpërmjet të konferencave, përderisa dialogu me Beogradin do të lehtësohet nëpërmjet takimeve dhe seminareve në lëminë e negociimit dhe dialogut politik. Krahas kësaj, shtylla e tretë (OSBE-ja) do të ofrojë ndihmë teknike për drejtorin ekzekutiv të Institutit Kosovar për Administratë Publike (IKAP) në identifikimin e trajnuesve, hartimin e strategjisë trajnuese dhe identifikimin e nevojave për ngritjen e stafit në komuna dhe ministri përkatëse. Së fundi shtylla e tretë (OSBE) do të këshillojë dhe mbështesë menaxhmentin dhe administratën e IKAP-it në marrjen e teknikave dhe standardeve për udhëheqjen sa më të mirë të një institucioni trajnues.
- *Programi për pjesëmarrje qytetare* nxit bashkëveprimin e drejtpërdrejtë ndërmjet rrjeteve të ndryshme të shoqërisë civile, OJQ-ve dhe grupeve qytetare. Për të shtuar njohurinë e publikut mbi grupet e nën përfaqësuar, shtylla e tretë (OSBE-ja) zhvillon një sërë aktivitete për të mbështetur zërin e gruas dhe çështjet e të rinjëve në mediat kosovare, me qëllim të plotësimit të mbështetjes për qeverisjen në nivel qëndror ashtu edhe në atë lokal.
- *Përkrahja e mediave* ka për qëllim krijimin e një shoqate të vetme dhe të unifikuar të gazetarëve në Kosovë dhe krijimin e mediave të qëndrueshme, të përgjegjshme dhe profesionale. Trajnimi për mediat i cili do t'u ofrohet institucioneve kosovare nëpërmjet themelimit të Shkollës së Gazetarisë në Prishtinë me ndihmën e shtyllës së tretë (OSBE-së) e cila do të ofrojë këshilla mbi planprogramin mësimor. Themelimi i një autoriteti të pavarur rregullativ për mediat, i cili pritet të ndodhë në të ardhmen, do të avansojë edhe më tej aftësinë e Kosovës për t'i rregulluar vetë çështjet e veta. Në këtë aspekt, do të ofrohet edhe mbështetje nëpërmjet këshillave praktike ligjore për të nxjerrur legjislacionin përkatës, përfshirë këtu edhe ligjin mbi transmetimin, lirinë e informacionit, shpifjen dhe përgojimin, mbrojtjen e pakicave dhe të drejtat e autorit.

Krahas kësaj, shtylla e tretë (OSBE) mbështet institucionet e përkohshme duke dhënë këshilla dhe udhëzime *in situ* zyreve këshilldhënëse të kryeministritë: (a) për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore; dhe (b) zyrës së komuniteteve. Këshilltarët e OSBE-së janë duke punuar drejt krijimit të kuadrovë në kuadër të zyreve këshilldhënëse të kryeministritë dhe ministrive përkatëse, të cilat do të monitoronin praktikën e qeverisjes në kuadër të ministrive; do të shqyrtonin draft legjislacionin dhe do të hartonin udhëzime mbi zbatimin e këtij legjislacioni.

Sa i përket programeve të Departamentit për Sundim të Ligjit, fokusi i aktiviteteve të tij do të zhvendoset nga mbështetja për zhvillimin e institucioneve të krijuara nga ky departament gjatë viteve të kaluara, në dhënien e këshillave këtyre institucioneve sikurse edhe organeve tjera ligjore që nuk i përkasin shtyllës së tretë (OSBE-së) në hartimin e programeve për forcimin e sundimit të ligjit dhe sigurimit të qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë. Programet e tilla do të mbështesin Odën e Avokatëve në ngritjen e kuadrove trajnuese për të përkrahur sundimin e ligjit duke ngritur aftësitë e OJQ-ve vendëse për të ofruar ndihmë juridike civile. Qendra Juridike e Kosovës, për të cilën financimi nga ana e OSBE-është përgjysmuar, do të vazhdojë të mbështesë Fakultetin Juridik në Prishtinë dhe në Mitrovicë. Instituti Gjyqësor i Kosovës do të vazhdojë të ofrojë arsimim të vazhdueshëm ligjor për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë. Ky institut do të fillojë të ofrojë arsimim ligjor fillestar për kandidatët për gjyqtarë ose prokurorë, si dhe do të ofrojë një përmbledhje të sistemit juridik për gjyqtarët porotë dhe trajnimin promovues për zyrtarët të cilët do të avansohen në detyrë në kuadër të sistemit të gjykatave/prokurorive. Instituti Gjyqësor i Kosovës do të financohet përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës edhe pse OSBE-ja vazhdon të delegojë tre anëtarë ndërkombëtare të stafit për të mbështetur qëndrueshmërinë e këtij institucioni.

Krahas kësaj, departamenti do të vazhdojë t'i mbajë tri njësi të specializuara në lëminë e të drejtave të njeriut në kuadër të selisë së Misionit të OSBE-së.

- □ *Njësia për Monitorim të Sistemit Ligjor* do të vazhdojë punën e saj me gjyqësinë.
- □ Një funksion i ri për ngritjen e kuadrove do të ushtrohet nga *Njësia për Ngritjen e Kuadrove* (e quajtur më parë si Njësia për Trajnim dhe Promovim).
- □ *Pika Fokale për Trafikimin* do të vazhdojë të zbatojë në praktikë projektet e saj që kanë të bëjnë me viktimat e trafikimit me njerëz.

Në vitin 2004, Departamenti i Zgjedhjeve do t'i ushtrojë përgjegjësitë e tij në fushën e zgjedhjeve me një ndryshim thelbësor në krahasim me vitet e kaluara kur janë mbajtur zgjedhjet. Përgjegjësinë për mbajtjen e zgjedhjeve ky departament do ta ndajë me Sekretariatit e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, tani në funksion edhe në bazë ligjore. Departamenti do të mbajë përgjegjësi operacionale për aktivitete të caktuara të ndieshme dhe do të ushtrojë funksion të fuqishëm këshilldhënës për ato përgjegjësi të cilat i janë bartur Sekretariatit. Për shembull, Sekretariati do të marrë përsipër detyrat operative të cilat kërkohen në nivelin komunal dhe disa detyra që kërkohen në nivelin qëndror. Për ta realizuar këtë bartje të përgjegjësisë, departamenti do të vazhdojë, dhe përfundojë në vitin 2004, programet për zhvillim dhe trajnim profesional të stafit të Sekretariatit të inicuar gjatë vitit të kaluar. Për të realizuar qëllimin e projektit të përshkruar më lartë, Departamenti i Zgjedhjeve do të strukturohet për të ushtruar 4 përgjegjësitë kryesore të punës së tij.

- (i) Operacionet e mbajtura. OSBE-ja do të vazhdojë të jetë përgjegjëse për përgatitjen e listave të votuesve, për një version të modifikuar të programit të votimit për votuesit jashtë Kosovës dhe do të jetë përgjegjëse edhe për planifikimin dhe udhëheqjen e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve. Krahas kësaj, OSBE-ja do të vazhdojë të mbajë zyrën e saj për regjistrimin e partive politike dhe revizionin financiar të tyre, si dhe organin e apelit i cili do të vazhdojë t'i shqyrtojë ankesat të cilat parashtrohen në lidhje me përgatitjen e zgjedhjeve dhe aktivitetet e ditës së zgjedhjeve. Së fundi, OSBE-ja do të mbajë gjithashtu edhe njësinë kundër mashtrimit për të hetuar rastet e dyshuara të mashtrimit dhe frikësimit gjatë procesit zgjedhor.
- (ii) Funksionet trajnuese dhe këshilldhënëse. Stafit trajnues i Departamentit të Zgjedhjeve (DZ-së) dhe ekspertët dhe këshilltarët tjerë relevant do të vazhdojnë të jenë pjesë e këtij programi tejet ambicioz. Këto ekupe do të vazhdojnë të mbesin aktive gjatë procesit zgjedhor për tu ofruar këshilla dhe udhëzime stafit të sekretariatit.

- (iii) Detyrat e vazhdueshme ligjore mbikëqyrëse dhe rregullative. OSBE-ja do të vazhdojë të luajë rol kyç në përgatitjen apo konsolidimin e elementeve të kornizës rregullative zgjedhore duke punuar ngushtë me KQZ-në dhe Kombet e Bashkuara. Si OSBE-ja ashtu edhe Sekretariati i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve do të funksionojë zyrtarisht nën udhëheqjen dhe direktivat e KQZ-së. Sidoqoftë, Zyra e PSSP-së mbetet autoriteti i fundit në bazë të kushteve të parashikuara me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe Kornizën Kushtetuese.

Sekretariati i KQZ-së, i financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, do të planifikojë dhe ekzekutojë detyra të specifikuar dhe do të krijojë infrastrukturën e duhur. Shembujt e këtyre detyrave specifike janë si në vijim: certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve, certifikimi i vëzhguesve, dizajnimi dhe shtypja e fletëvotimeve, informimi publik, trajnimi i stafit komunal të cilët do të ushtrojnë përgjegjësi të caktuara në kuadër të vendvotimeve, menaxhmentit të qendrave të votimit dhe në fushën e ruajtjes, shpërndarjes dhe mbledhjes së materialeve të nevojshme zgjedhore.

Qëllimi i Departamentit për Edukim dhe Zhvillim Policor është promovimi i një institucioni i cili do t'i ofronte Kosovës një shërbim për zbatimin e ligjit i cili është i qëndrueshëm dhe i bazuar në komunitet: shërbim ky i cili do të jetë i përkushtuar për ruajtjen e rendit dhe ligjit, përkrahjen e sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe i bazuar në standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Në këtë aspekt, departamenti në fjalë do të jetë partner mbështetës me të gjitha institucionet e policisë së UNMIK-ut dhe Shtyllën e Drejtësisë (Shtylla I) dhe do të ndihmojë në zhvillimin e një sistemi juridik efikas dhe të shëndoshë. Qëllimet e programit përqëndrohen në aktivitetet e paraqitura si në vazhdim:

- (i) Zhvillimin e një shërbimi të qëndrueshëm, reprezentativ, të bazuar në komunitet dhe profesional për zbatimin e ligjit;
- (ii) Hartimin e një kornize ligjore duke definuar dhe mbajtur një nivel minimal të kompetencave për zbatim profesional të ligjit;
- (iii) Ngritjen e kuadrove vendëse për ruajtjen e standardeve të një shërbimi profesional policor dhe për trajnim;
- (iv) Lehtësimin e bartjes së këtyre përgjegjësive institucionale.

Shkolla Policore do të vazhdojë me trajnimin e vet themelor për rekrutët e rinj pranë Skollës Policore dhe planifikon të trajnojë 700 oficerë të shkallës hyrëse në Shkollë Policore. Vëmendje e rëndësishme është zhvendosur nga trajnimi fillestar drejt trajnimeve të avansuara dhe atyre të specializuara. Ky trajnim ndërlihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ngritjen e kuadrove në kuadër të SHPK-së të cilët do të merrnin përgjegjësi më të mëdha për operacionet e përditshme policore dhe plotëson tranzicionin nga policia e UNMIK-ut në SHPK.

Standardet bashkëkohore evropiane për trajnim policor kërkojnë një zhvillim të vazhdueshëm profesional. Të njëjtat kondita janë hartuar edhe për SHPK-në dhe së këndejmi menaxhohen dhe jetësohen nga Shkolla Policore. Duke vënë një theks të posaçëm në tranzicionin në vazhdim, një numër i madh i programeve të dedikuara për këtë vit përqëndrohen në ngritjen e kuadrove vendëse. Kjo do t'i mundësojë stafit vendor të zëvendësojë stafin ndërkombëtar në ushtrimin e funksioneve të caktuara pranë këtij institucioni. Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi mbi Trafikun janë reviduar dhe pritet të hyjnë në fuqi gjatë vitit 2004, për të cilën gjë kërkohet një trajnim gjithëpërfshirës për të punësuarit në kuadër të sistemit të policisë dhe drejtësisë. Gjatë vitit 2004 rreth 300 policë të SHPK-së do të trajnohen në fushën e menaxhimit dhe mbikëqyrjes. Deri në dhjetor të vitit 2003, rreth 2,220 policë të SHPK-së kanë marrë pjesë në trajnimet fillestare, përderisa 2,500 të tjerë pritet të trajnohen në të ardhmen.

Departamenti i OSBE-së për Edukim dhe Zhvillim Policor (DPED), ka ngritur kuadro unike për trajnim dhe zhvillim profesional, si dhe odron trajnime të këtilla në kuadër të institucioneve qeveritare. DPED parashikon të ndryshojë emrin e ShShPK-së me qëllim të pasqyrimin të kapacitetit trajnues në rritje për siguri publike i cili po

ndodh aktualisht. Gjithashtu po zhvillohet një dialog i vazhdueshëm për identifikimin e pozitës së kësaj shkolle në fushën e trajnimit profesional dhe në kuadër të IPVQ-ve.

Që nga muaji maj 2003, shtylla III (OSBE-ja) ka themeluar një Zyrë për operacione jashtë-buxhetore (menaxhim të donacioneve). Kjo zyrë është përgjegjëse për konsolidimin e çështjes së financimit të programeve të departamenteve dhe institucioneve të krijuara nga OSBE-ja nga burimet e jashtme. Si e tillë, kjo zyre do të shërbejë si një pikë kontakti në mes të misionit të OSBE-së dhe donatorëve (p.sh qeverive, shteteve pjesëmarrëse, agjencive donatore, institucioneve të jashtme, organizatave dhe individëve të ndryshëm). Informatat shitesë mbi projektet për të cilat misioni i OSBE-së është duke avokuar për të gjetur financim mund të gjinden në faqen e internetit www.osce.org/osceprojects/index.php apo nepërmjet e-mailit ebou@omik.org.